

	<b>KONKURS PUBLIK</b>	<b>DT-BNJ-027</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 1 nga 5</i>
<i>Departamenti i Burimeve Njerëzore</i>		<i>Sektori i Personelit</i>

Bazuar në nenet 8, 10 (paragrafi 2.2.) dhe 15 të Ligjit të punës nr.03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenet 5 (paragrafi 1, 2, 4, 5) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-nr. 01/2024 dhe plotësim ndryshimit të UA 03/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, nenet 5.3.2 dhe 7.1 të Manualit të punëtorëve si dhe nenet 6.2, 7.3 dhe 9.2 të Politikës së rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. për plotësim të vendeve të lira të punës si më poshtë, shpall:

### KONKURS PUBLIK

1. Operator në nivelin 110(220)/x kV/kV (9 kryes)
2. Operator në nivelin 400/220/110 kV (nyje aktive) (2 kryes)

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Operator në nivelin 110(220)/x kV/kV</b>
<b>Ndërmarrja:</b>	<b>KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.</b>
<b>Numri referues:</b>	<b>1.6.7.7</b>
<b>Kohëzgjatja e kontratës:</b>	<b>1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj</b>
<b>Orari i punës:</b>	<b>Puna me orar të plotë</b>
<b>Lartësia e pagës bazë mujore:</b>	<b>617.00 euro</b>
<b>Numri i kryesve:</b>	<b>9</b>
<b>Kushtet e punës:</b>	<b>Puna në Nënstacion</b>
<b>Vendi i punës (lokacioni):</b>	<b>1 kryes në NS Deçani 1, 1 kryes në NS Gjakova 1, 2 kryes në NS Ferizaji 1, 1 kryes në NS Gjilani 5, 2 kryes në NS Prishtina 1, 1 kryes në Prizreni 3, 1 kryes në NS Ilirida</b>
<b>Mënyra e aplikimit:</b>	<b>Adresa elektronike (email)</b>

#### **Përmbledhje e detyrave për pozitën: Operator në nivelin 110(220)/x kV/kV**

##### **Detyrat e përgjithshme:**

Është përgjegjësi kryesor për të gjitha operimet në NS 110 (220)/ x kV/kV. Gjatë tërë orarit të punës duhet të bashkëpunojë ngushtë me Dispeçerin e Qendrës Nacionale (QND), Përgjegjësin e operimit të nënstacionit, Përgjegjësin Regjional për operim të NS dhe Menaxherin e Sektorit për operim të NS. Me urdhër të Dispeçerit operon me stabilimentet në NS për funksionim të mbarëvajtjes së tërësishme të nënstacionit dhe SEE të Republikës së Kosovës në tërësi.

##### **Detyrat specifike:**

Përmes Dispeçerëve të QND, operatorët kryejnë të gjitha obligimet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe operimin e pajisjeve në nënstacion dhe krijojnë kushte të punës për ekipet e mirëmbajtjes së nënstacioneve dhe linjave. Ai i raporton sipas hierarkisë:

- Përgjegjësit për operimit të nënstacionit,

- Përgjegjësit Regional për operim të NS dhe
- Menaxherit të Sektorit për operim të NS

**Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë:**

- Zbatoj në përpikëri Procedurën për Operim
- Kryej operime me të gjitha llojet e pajisjeve elektrike me urdhër të dispeçerit, duke respektuar Procedurën e Operimit, si me ndërprerësit e fuqisë të Autotransformatorëve, transformatorëve, linjave apo zbarrave, ndarësit, tokëzimet
- Monitoroj performancën e nënstacionit
- Siguroj qasje të sigurtë në nënstacione për mirëmbajtje dhe punë të reja ndërtimore
- Mbikëqyrë dhe merr pjesë në mirëmbajtjen e nënstacionit
- Mbaj shënime për të gjitha veprimtaritë në nënstacion
- Evidentoj kohët e operimeve
- Evidentoj rëniet e stabilimenteve elektroenergjetike në kohë reale, deshifrimi i mbrojtjeve të cilat kanë vepruar
- Mbaj evidencë për gjendjen e furnizimit vetanak, e në rast nevojë lajmëron përgjegjësit sipas hierarkisë
- Kryej kontrole ditore dhe periodike të stabilimenteve elektroenergjetike të nënstacionit, mban evidencë dhe raporton për gjendjen e tyre
- Kontrollon punën normale të pajisjeve të komunikimit me qendrën dispeçerike dhe në rast të parregullsive njofton personat kompetent për riparimin e tyre
- Monitoroj dhe regjistroj situatat e jashtëzakonshme në pjesën komanduese gjatë eksploatimit, njoftimi i dispeçerit kujdestar në lidhje me rrjedhën e situatave të tilla dhe merr instruksione për veprime të mëtutjeshme (në raste të veçanta njofton personelin mbikëqyrës të NS sipas hierarkisë, në mungesë të tyre Drejtorin e Departamentit të Transmisionit)
- Ruaj dokumentacionin teknik të nënstacionit,
- Gjatë tërë orarit të punës nuk guxon të largohet nga objekti
- Ndaloj hyrjen në objekt të personave të paautorizuar të cilët nuk kanë leje paraprake nga Sektori i operimit të nënstacioneve
- Mbaj pastërtinë në objekt
- Sipas nevojës, Menaxheri i Operimit e cakton në NS e të njëjtit nivel në të cilin duhet të punojë

**Të tjera:**

Kryen detyra tjera të cilat kërkohen nga Përgjegjësi i nënstacionit apo Menaxheri i Operimit dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it dhe sistemit në tërësi.

**Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:**

**Shkollimi:** Shkolla e mesme Elektroteknike apo Teknike  
**Dega/drejtimi/profili:** Elektroenergjetikë, Instalime elektrike apo profile tjera elektrike

- Përvojë pune profesionale minimum 6 muaj
- Njohja e punës me kompjuter
- Besueshmëria dhe përpikëria

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Operator në nivelin 400/220/110 kV (nyje aktive)</b>
<b>Ndërmarrja:</b>	<b>KOSTT - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A.</b>
<b>Numri referues:</b>	<b>1.6.7.3</b>
<b>Kohëzgjatja e kontratës:</b>	<b>1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj</b>
<b>Orari i punës:</b>	<b>Puna me orar të plotë</b>
<b>Lartësia e pagës bazë mujore:</b>	<b>695.00 euro</b>
<b>Numri i kryesve:</b>	<b>2</b>
<b>Kushtet e punës:</b>	<b>Puna në Nënstacion</b>
<b>Vendi i punës (lokacioni):</b>	<b>1 kryes NS Kosova A, 1 kryes NS Kosova B</b>
<b>Mënyra e aplikimit:</b>	<b>Adresa elektronike (email)</b>

### **Përmbledhje e detyrave për pozitën: Operator në nivelin 400/220/110 kV (nyje aktive)**

#### **Detyrat e përgjithshme:**

Është përgjegjësi kryesor për të gjitha operimet në NS 400/220/110 kV/kV (Nyje Aktive). Gjatë tërë orarit të punës duhet të bashkëpunojë ngushtë me Dispeçerin e Qendrës Nacionale (QND), Përgjegjësin e operimit të nënstacionit, Përgjegjësin Regjional për operim të NS dhe Menaxherin e Sektorit për operim të NS. Me urdhër të Dispeçerit operon me stabilimentet në NS, në funksionon të mbarëvajtjes së tërësishme të nënstacionit dhe SEE të Republikës së Kosovës në tërësi.

#### **Detyrat specifike:**

Përmes Dispeçerëve të QND Operatorët kryejnë të gjitha obligimet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe operimin e pajisjeve në nënstacion dhe krijon kushte të punës për ekipet e mirëmbajtjes së nënstacioneve dhe linjave. Ai i raporton sipas hierarkisë:

- Përgjegjësit për operim të nënstacionit,
- Përgjegjësit Regjional për operim të NS dhe
- Menaxherit të Sektorit për operim të NS

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e tij specifike janë:**

- Zbatoj në përpikëri Procedurën për Operim,
- Kryej operime me të gjitha llojet e pajisjeve elektrike me urdhër të dispeçerit, duke respektuar Procedurën e Operimit, si me ndërprerësit e fuqisë të Autotransformatorëve, transformatorëve, linjave apo zbarrave, ndarësit, tokëzimet
- Monitoroj performancën e nënstacionit
- Siguroj qasje të sigurtë në nënstacione për mirëmbajtje dhe punë të reja ndërtimore
- Mbikëqyr dhe merr pjesë në mirëmbajtjen e nënstacionit
- Mbaj shënimeve për të gjitha veprimtaritë në nënstacion
- Evidentoj kohët e operimeve
- Evidentoj rëniet e stabilimenteve elektroenergjetike në kohë reale, deshifrimi i mbrojtjeve të cilat kanë vepruar
- Mbaj evidencë për gjendjen e furnizimit vetanak, e në rast nevojë lajmëron përgjegjësit sipas hierarkisë

- Kryej kontrolle ditore dhe periodike të stabilimenteve elektroenergjetike të nënstacionit, mban evidencë dhe raporton për gjendjen e tyre
- Kontrollon punën normale të pajisjeve të komunikimit me qendrën dispeçerike dhe në rast të parregullsive njofton personat kompetent për riparimin e tyre.
- Monitoroj dhe regjistroj situatat e jashtëzakonshme në pjesën komanduese gjatë eksplotimit, njoftimi i dispeçerit kujdestar në lidhje me rrjedhën e situatave të tilla dhe merr instruksione për veprime të mëtutjeshme (në raste të veçanta njofton personelin mbikëqyrës të NS sipas hierarkisë, në mungesë të tyre Drejtorin e Departamentit të Transmisionit)
- Ruaj dokumentacionin teknik të nënstacionit
- Gjatë tërë orarit të punës nuk guxon të largohet nga objekti
- Ndaloj hyrjen në objekt të personave të paautorizuar të cilët nuk kanë leje paraprake nga Sektori i operimit të nënstacioneve.
- Mbjaj pastërtinë në objekt
- Sipas nevojës, Menaxheri i Operimit e cakton në NS e të njëjtit nivel në të cilin duhet të punojë

### **Të tjera**

Kryen punë tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri i Sektorit të Operimit të Nënstacioneve dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

### **Kërkesat profesionale/Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:**

**Shkollimi:** Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

**Dega/drejtimi/lëmia:**

- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri lidhur me punën në nënstacione elektrike
- Njohja e punës me kompjuter
- Besueshmëri dhe përpikëri
- Aftësi shëndetësore

### **Njoftimi me rezultatin e konkursit**

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik aplikantët/kandidatët do të njoftohen pas çdo faze të zhvillimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve

### **Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve**

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve

Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik

Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë

Intervista deri në njëzet (20) pikë

Jetë përshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë

### **Mënyra e aplikimit**

Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike, përmes adresës elektronike. Dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave të konkursit. Pasi të dërgoni aplikimin tuaj përmes email adresës elektronike do të pranoni

një email për konfirmim të pranimit të email-it tuaj. Nëse nuk keni pranuar email-in konfirmues, atëherë shkruani në email adresën [punesimi@kostt.com](mailto:punesimi@kostt.com) (vetëm në rastin kur pas aplikimit nuk e keni pranuar email-in konfirmues).

**Dokumentet që duhet të ngarkohen dhe dërgohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dërgimit të tyre:**

Gjatë aplikimit për pozitën në fjalë kandidatët duhet të kenë kujdes hapat e aplikimit:

- Aplikimi bëhet vetëm përmes adresës (postës) elektronike (email) [punesimi@kostt.com](mailto:punesimi@kostt.com)
- Në email për aplikim duhet të bashkëngjiten (ngarkohen) dokumentet si në vijim:
  - Aplikacionin-CV-në (**ver. 4.0**) të shkarkuar nga web faqja zyrtare e KOSTT Sh. A. : [www.kostt.com](http://www.kostt.com)
  - Dëshmia për kualifikimin profesional: Diploma e shkollimit e skanuar në formatin pdf dhe e bashkëngjitur në email (*nëse diploma është fituar jashtë vendit duhet bashkëngjitur vërtetimin e nostrifikimit të diplomës apo aktin që dëshmon se diploma është në procedurë të nostrifikimit me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës*).
  - Dëshmia për përvojën profesionale: Vërtetim pune (referencë) nga punëdhënësit tuaj të mëparshëm apo aktual me të cilën vërtetohet përvoja juaj për profesionin që keni. Në vërtetim (referencë) duhet të jetë data e fillimit dhe mbarimit të punësimit apo angazhimit tuaj tek punëdhënësi juaj.
  - Dëshmi tjera të dokumenteve sipas kërkesave dhe kritereve të konkursit të brendshëm.

**Vërejtje:** Gjatë aplikimit aplikantët/kandidatët duhet të kenë gjithashtu kujdes, si në vijim:

Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes suaj është në marrëdhënie pune me KOSTT, në cilëndo fazë të zhvillimit të vlerësimit të kandidatit që vërtetohet, aplikacionet-CV-të tuaja do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa ato të mangëta ose ato që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat/kriteret e konkursit të shpallur në tabelën e shpalljeve në KOSTT.

Dokumentacioni shtesë të dërguara nga kandidati pas përfundimit të afatit të aplikimit nuk mund të kërkohej dhe as të pranohet.

Kalendari i përafërt: Pas përfundimit të afatit të aplikimit, brenda 20 dite testimi me shkrim, brenda 15 dite intervista, brenda 5 dite njoftimi final, si dhe brenda 15 dite lidhje e marrëdhënies së punës me kandidatin e suksesshëm.

Kalendari i përafërt do të aplikohet në rast se nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë të rrjedhës së procesit të konkursit sipas UA nr. 01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe në bazë të akteve të brendshme Manualit të punëtorëve dhe Politikës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve në KOSTT, nga data 19.09.2025 deri më 03.10.2025 ora 24:00.